



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 724, datë 07.12.2023

**PËR
RINDARJEN ME SHORT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjat ‘d’ dhe ‘ë’, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën ‘d’, të pikës 3, të nenit 25, të Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 4, të nenit 94 dhe shkronjën ‘c’, pika 1, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

**Neni 1
Objekti**

Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i rasteve dhe kriterëve për rindarjen e çështjeve gjyqësore me short, në të gjitha nivelet e gjykatave në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë në kuptim të termit “Seksion” edhe Kolegjet e Gjykatës së Lartë.

**Neni 2
Qëllimi**

Rindarja me short e çështjeve gjyqësore ka për qëllim caktimin e gjyqtarit të ri relator në gjykimin e një çështjeje gjyqësore, si në rast kur ai gjykon i vetëm ashtu edhe kur gjykon në trup gjykues kolegjal. Rregullat për formimin e mëtejshëm të trupit gjykues, përcaktohen me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 3 Parimet

Rindarja e çështjeve gjyqësore me short realizohet mbi bazën e parimit të procesit të rregullt ligjor, transparencës, informimit, kontrollit, mbikëqyrjes, gjurmimit, barazisë së shpërndarjes, efiçencës dhe objektivitetit.

Neni 4 Mënyra e rindarjes së çështjeve me short

Rindarja e çështjeve me short kryhet vetëm nëpërmjet sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore dhe i nënshtrohet të njëjtave rregulla të parashikuara në Kreun II të vendimit Nr. 554, datë 29.12.2022 “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 5 Rastet e rindarjes me short të çështjeve gjyqësore

1. Çështjet rindahen me short në rastet e mëposhtme:

- a) për shkak të miratimit të dorëheqjes ose vendimit të përjashtimit të gjyqtarit, sipas ligjit.
- b) për shkak të mbarimit të statusit të gjyqtarit, sipas ligjit.
- c) për shkak të caktimit të përkohshëm, komandimit, transferimit ose ngritjes në detyrë sipas përcaktimeve të vendimit të KLGJ, sipas ligjit;
- ç) kur zgjidhet anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas ligjit;
- d) për shkak të pezullimit përkohësisht nga detyra për shkak të ligjit me vendim të KLGJ, sipas ligjit;
- dh) nuk paraqitet përkohësisht në detyrë për arsye që lidhen me:
 - i) paaftësinë shëndetësore gjatë periudhës së përfitimit të mbrojtjes së detyrueshme nga sigurimet shoqërore;
 - ii) përfitimin e lejes së papaguar;
 - iii) përfitimin e lejes së veçantë.
- e) kur pozicioni i magjistratit suprimohet për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative;
- ë) për shkak të riorganizimit gjyqësor e suprimimit të gjykatës;
- f) për shkak riorganizimit të brendshëm të gjykatës përmes:
- g) krijimit të seksioneve të reja;
 - ii) shtimit ose pakësimit të trupave gjyqësore në një seksion;
 - iii) caktimit të gjyqtarit në një seksion tjetër.
- gj) shtimi i gjyqtarëve në gjykatë.

2. Nuk rindahen me short çështjet urgjente për të cilat, çdo fillim viti, kryetari i gjykatës, në zbatim të shkronjës “b”, të nenit 37, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ka miratuar listën e gjyqtarëve për gjykimin e tyre. Rindarja e këtyre çështjeve bëhet sipas aktit të kryetarit të gjykatës, i nxjerrë në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

3. Kryetarët e gjykatave, në çdo rast tjetër, tej atyre të përcaktuara në këtë vendim, kur vlerësojnë se zgjidhja e një situatë konkrete që ka të bëjë me efikasitetin e drejtësisë mund të bëhet vetëm përmes rindarjes me short të çështjeve gjyqësore, duhet të informojnë menjëherë Këshillin e Lartë Gjyqësor për të vlerësuar nëse ajo situatë përbën një rast nevojë që justifikon rindarjen me short të çështjeve gjyqësore.

Neni 6

Kriteret për rindarjen me short të çështjeve për rrethana që kanë të bëjnë me gjyqtarin të cilit i janë caktuar

1. Çështjet e ndara me short, për të cilat bëhet e nevojshme rindarja e tyre për shkak të ndërprerjes së ushtrimit të funksionit të gjyqtarit të cilit i janë caktuar, rindahen me short menjëherë pas vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për këtë gjyqtar.

2. Rindarja e çështjeve me short në rastin e gjyqtarit që ndërpret përkohësisht ushtrimin e funksionit, është përgjegjësi e kryetarit të gjykatës. Në këtë rast, kryetari i gjykatës vlerëson shkakun konkret të lindur për rindarjen e çështjeve me short, shkallën e urgjencës së çështjeve, fazën e gjykimit të tyre, si edhe kohën ose pritshmëritë për rifillimin e ushtrimit të funksionit të gjyqtarit të cilit i janë caktuar. Bazuar në rrethana të njohura apo në informacionet e marra nga autoritetet përkatëse, kryetari i gjykatës, nëpërmjet një akti të motivuar, mund të urdhërojë rindarjen e të gjitha çështjeve të atij gjyqtari apo të një pjese apo kategorie të caktuar të tyre, si dhe për kohën e rindarjes me short të çështjeve.

3. Çështjet e ndara me short, për të cilat bëhet e nevojshme rindarja e tyre për shkak të ndërprerjes, përkohësisht ose përfundimisht, të ushtrimit të funksionit në atë gjykatë, të gjyqtarit të cilit i janë caktuar, rindahen me short menjëherë me konfirmimin e shkakut të rindarjes së çështjeve.

4. Çështjet e ndara me short, për të cilat bëhet e nevojshme rindarja e tyre, në rastin kur ato i janë caktuar gjyqtarit, si gjyqtar i vetëm, rindahen me short ndërmjet gjyqtarëve të tjerë të seksionit përkatës të gjykatës dhe kur kjo nuk është e mundur, ndërmjet të gjithë gjyqtarëve të gjykatës.

5. Çështjet e ndara me short, për të cilat bëhet e nevojshme rindarja e tyre, në rastin kur ato i janë caktuar gjyqtarit si relator në një trup gjykues kolegjal, ndërsa shkak i rindarjes lind përpara fillimit të gjykimit ose përpara shpalljes së tyre për gjykim, rindahen me short ndërmjet gjyqtarëve të tjerë të seksionit përkatës të gjykatës dhe kur kjo nuk është e mundur, ndërmjet të gjithë gjyqtarëve të gjykatës.

6. Çështjet e ndara me short, për të cilat bëhet e nevojshme rindarja e tyre, në rastin kur ato i janë caktuar gjyqtarit si relator në një trup gjykues kolegjal, ndërsa shkak i rindarjes lind gjatë gjykimit të tyre ose kur çështjet janë shpallur për gjykim, rindahen me short për përcaktimin e relatorit ndërmjet anëtarëve të tjerë të trupit gjykues, i cili më pas plotësohet me një anëtar tjetër.

Neni 7

Kriteret për rindarjen me short të çështjeve për rrethana që kanë të bëjnë me gjykatën ku janë regjistruar

1. Çështjet e ndara me short, për të cilat bëhet e nevojshme rindarja e tyre për rrethana që kanë të bëjnë me gjykatën ku janë regjistruar, rindahen me short menjëherë me konfirmimin e shkakut të rindarjes së çështjeve, si dhe në varësi të shkakut konkret të rindarjes.

2. Në rastin e suprimimit të gjykatës për shkak të riorganizimit gjyqësor, çështjet rindahen me short pas regjistrimit të tyre në gjykatën kompetente nga pikëpamja tokësore. Nëse gjyqtari i gjykatës së suprimuar caktohet në gjykatën që përcaktohet si kompetente nga pikëpamja tokësore, çështjet e caktuara atij më parë me short nuk rindahen, por i kalojnë këtij gjyqtari.

3. Në rastin e krijimit të seksioneve të reja në gjykatë, çështjet që i përkasin këtyre seksioneve rindahen me short me krijimin e tyre. Në këtë rast rindahen me short vetëm ato çështje gjykimi i të cilave nuk ka filluar për gjykatat e shkallës së parë apo ato çështje të cilat nuk janë shpallur për gjykim në gjykatat e niveleve më të larta. Kryetari i gjykatës është autoriteti që vendos për rindarjen me short të çështjeve në rastin e krijimit të seksioneve të reja në gjykatë, si dhe për përcaktimin e çështjeve të regjistruara më parë që do të rishortohen.

4. Në rastin e shtimit të trupave gjykuese në një seksion të gjykatës, çështjet e seksionit ku shtohen trupat gjykues rindahen me short me krijimin e trupave të reja gjykuese. Në këtë rast rindahen me short vetëm ato çështje gjykimi i të cilave në shkallë të parë nuk ka filluar apo ato çështje të cilat nuk janë shpallur për gjykim në gjykatat e niveleve më të larta. Kryetari i gjykatës është autoriteti që vendos për rindarjen me short të çështjeve në rastin e shtimit të trupave gjykuese në gjykatë, si dhe për përcaktimin e rrethit të çështjeve që do të rishortohen, me qëllim që ngarkesa e punës për gjyqtarët e caktuar rishtazi në një seksion të gjykatës, për aq sa është e mundur, të jetë jo më e lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të këtij

seksioni, si dhe të përfshijë çështje të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre në gjykatë dhe të kategorive të ndryshme.

5. Në rastin e pakësimit të trupave gjykuese në një seksion të gjykatës, çështjet e gjyqtarëve të trupave gjykuese të pakësuar, me daljen e vendimit përkatës të këshillit të gjykatës, rindahen me short ndërmjet gjyqtarëve të tjerë të këtij seksioni. Në këtë rast rindahen me short vetëm ato çështje gjykimi i të cilave në shkallë të parë nuk ka filluar apo ato çështje të cilat nuk janë shpallur për gjykim. Kryetari i gjykatës është autoriteti që vendos për rindarjen me short të çështjeve në rastin e pakësimit të trupave gjykuese në një seksion të gjykatës, si dhe për përcaktimin e çështjeve që do të rishortohen.

6. Në rastin e caktimit të gjyqtarit në një seksion tjetër të gjykatës, çështjet e këtij gjyqtari, me caktimin e tij në një seksion tjetër nga këshilli i gjykatës, rindahen me short ndërmjet gjyqtarëve të tjerë të seksionit ku ky gjyqtar bënte pjesë. Në këtë rast rindahen me short vetëm ato çështje gjykimi i të cilave në shkallë të parë nuk ka filluar apo ato çështje të cilat nuk janë shpallur për gjykim në gjykatat e niveleve më të larta. Kryetari i gjykatës është autoriteti që vendos për rindarjen me short të çështjeve në rastin e caktimit të gjyqtarit në një seksion tjetër të gjykatës, si dhe për përcaktimin e rrethit të çështjeve që do të rishortohen, me qëllim që ngarkesa e punës për gjyqtarin e caktuar rishtazi në një seksion tjetër, për aq sa është e mundur, të jetë jo më e lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të seksionit ku caktohet, si dhe të përfshijë çështje të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre në gjykatë dhe të kategorive të ndryshme.

7. Në rastin e shtimit të gjyqtarëve në gjykatë, çështjet e gjykatës dhe kur është rasti ato që i përkasin seksionit ku gjyqtarët e ardhur rishtazi caktohen, rindahen me short menjëherë dhe, kur është rasti, me caktimin e këtyre gjyqtarëve në seksione. Në këtë rast rindahen me short vetëm ato çështje gjykimi i të cilave në shkallë të parë nuk ka filluar apo ato çështje të cilat nuk janë shpallur për gjykim në gjykatat më të larta. Gjyqtarët e ardhur rishtazi, përmes rindarjes me short të çështjeve, ngarkohet me një numër çështjesh jo më të lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të asaj gjykate apo, kur është rasti, se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të seksionit përkatës të gjykatës në të cilin gjyqtarët e ardhur rishtazi caktohen. Kryetari i gjykatës është autoriteti që vendos për rindarjen me short të çështjeve në rastin e shtimit të gjyqtarëve në gjykatë, si dhe për përcaktimin e rrethit të çështjeve që do të rishortohen, me qëllim që ngarkesa e punës për gjyqtarët e ardhur rishtazi në gjykatë, për aq sa është e mundur, të përfshijë çështje të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre në gjykatë.

Neni 8
Zbatimi i vendimit

1. Ngarkohet Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor për kryerjen e procedurave dhe zhvillimeve të nevojshme në sistemin e menaxhimit të çështjeve, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR